

Terma Reference

Thirrje për grup ekspertësh (ekspert ligjor & ekonomist) për zhvillimin e analizës ligjore dhe financiare të transformimit të Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror 0-5 vjeç në Shërbime me bazë Komunitare për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes

Konsulenca	Grup ekspertësh (ekspert ligjor & ekonomist) për zhvillimin e analizës ligjore dhe financiare të transformimit të Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror 0-5 vjeç në Shërbime me bazë Komunitare për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes.
Projekti	“Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe ndarjes nga familja” zbatuar në partneritet me UNICEF (ALB/PCA202213/PD202359)
Kohëzgjatja e shërbimit	Dhjetor 2023 – Janar 2024
Lloji i kontratës	Kontratë Shërbimi
Data e fillimit të punës	05 dhjetor 2023

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë **grup ekspertësh, për zhvillimin e analizës ligjore dhe financiare të procesit të transformimit të Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror 0-5 vjeç**, në kuadër të projektit “Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe ndarjes nga familja” zbatuar në partneritet me UNICEF dhe financuar nga Qeveria Suedeze.

Kjo ekspertizë do të ofrohet në mbështetje të Komitetit Drejtues për Zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit pranë MSHMS, për realizimin e procesit të transformimit të shërbimeve në dy institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijët e grupmoshës 0-5 vjeç në Korçë dhe Vlorë, duke ofruar analizën ligjore dhe financiare të proceseve të transformimit, si dhe të propozimeve konkrete, **për metodologjinë që duhet ndjekur drejt transformimit të plotë, të Institucioneve në Qendra Komunitare, (sipas modelit të dizenuar), e shoqëruar me ndryshimet e nevojshme të akteve normative, për të institucionalizuar modelin e ri të shërbimeve.**

Informacion i Përgjithshëm:

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrim i projektit:

Projekti ka si qëllim të ofrojë dhe sigurojë mbështetje për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të ofrojë shërbime mbështetëse të integruara për fëmijët dhe familjet në nevojë dhe në nivel të lartë vulnerabiliteti nga abuzimi, shfrytëzimi dhe trafikimi. Projekti fokusohet jo vetëm në mbështetje për fuqizimin e familjeve dhe fëmijëve, por edhe pilotimin e shërbimeve të reja mbështetëse për fëmijën dhe familjen, familjet kujdestare profesionale si dhe ngritja e kapaciteteve për punonjësit që janë pjesë e ofrimit të shërbimeve dhe kujdesit social në kuadër të avancimit të procesit të deinstitutionalizimit.

Grupet përfituese dhe aktorët kyç:

- Prindër/ kujdestarë të identifikuar në nevojë për mbrojtje ose në nevojë për referim në shërbimet e kujdesit social;
- Fëmijë të vlerësuar në risk të mesëm ose të lartë ndaj shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit;
- Fëmijë të vendosur në shërbimet e përkujdesit shoqëror rezidencial;
- Familje me fëmijë në risk për tu institucionalizuar;
- Punonjës të strukturave vendore, përgjegjës për mirëqenien e fëmijëve;
- Punonjës të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Detyrat dhe përgjegjësitë për secilin ekspert:

Ekspert ligjor/jurist:

Eskperti jurist ka si detyrë të:

- Desk Revieë/ Analizë e legjislacionit në fuqi për shërbimet shoqërore dhe funksionet decentralizuese të pushtetit vendor, si dhe akteve normative, që rregullojnë veprimtarinë e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror në nivel qendror dhe lokal, duke bërë një analizë të hollësishme të niveleve të llogaridhënies, varësisë dhe burimeve njerëzore, përfshirë Shërbimin për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes (Ligj 121/2016 „Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në RSH“; Ligj 84/2022 „Për Buxhetin viti 2023“ ; VKM 898 date 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisë të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës; Udhezimi nr 9 date 20.03.2018; Vkm Nr 111/2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e Fondit Social“; VKM NR. 150/2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror“ etj)
- Të realizojë takime konsultuese me profesionistët në nivel qendror dhe lokal të përfshirë në menaxhimin e shërbimeve të ofruara në IPSH-të Vlorë dhe Korçë, (MSHMS, ShSSH, Bashkitë Vlorë dhe Korçë, drejtuesit e IPSH-ve Vlorë dhe Korçë);
- Realizojë analizën ligjore të procesit të transformimit të shërbimeve rezidenciale për fëmijë në shërbime komunitare me bazë familjen dhe në përputhje me Modelin e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen (model i miratuar në KD);
- Të konsultojë bazën ligjore dhe hapësirat e mundshme për propozime specifike për mbështetjen e procesit të transformimit;
- Të hartojë propozime konkrete për ndryshime që lindin nga metodologjia e realizimit të procesit të transformimit në nivel normativ dhe administrativ;
- Të prezantojë raportin pranë Komitetit Drejtues të De_i në bashkëpunim me ekspertin ekonomik.

Profili i ekspertit ligjor/jurist:

I. Kualifikime

- Diplomë universitare/pasuniversitare në shkencat juridike.

II. Eksperienca e punës

- Të ketë jo më pak se 10 vite eksperiencë pune në ofrimin e shërbimeve konsulente dhe përvojë në analiza ligjore dhe hartimin e propozimeve për ndryshime të kuadrit normativ apo ligjore, etj;
- Të ketë përvoja të mëparshme në analiza të ngjashme të sistemit të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale;
- Njohuri apo përvoja të mëparshme në fushën e deinstitutionalizimit përbëjnë avantazh;
- Njohuri shumë të mira në gjuhën angleze në formën e shkruar dhe të folur;
- Mundësi dhe dëshirë për të lëvizur në terren;
- Gadishmëri për përmbushjen e afateve të dakordësuara;
- Aftësi shumë të mira në komunikim, dhe menaxhim të situatave;
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur.

Ekspert ekonomist

Eksperti ekonomist ka si detyrë të :

- Të realizojë një Desk Review/Analizë të sistemit aktual të financimit të Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror në nivel qendror dhe lokal, duke bërë një analizë të hollësishme të shërbimeve të ofruara dhe kostove bashkëshoqëruese;
- Të realizojë takime konsultuese me profesionistët në nivel qendror dhe lokal të përfshirë në buxhetimin e shërbimeve në IPSH-të Vlorë dhe Korçë, (MSHMS, ShSSH, Bashkitë Vlorë dhe Korçë, drejtuesit e IPSH-ve Vlorë dhe Korçë);
- Të mbledhë informacionin e nevojshëm për shpërndarjen e burimeve, kufizimet buxhetore, mekanizmat e financimit, modelet e personelit, kërkesat e përdorimit të shërbimit, logjistikës etj.
- Të realizojë analizën buxhetore të procesit të transformimit të shërbimeve rezidenciale për fëmijë në shërbime komunitare me bazë familjen dhe në përputhje me Modelin e Shërbimeve Mbështetëse për fëmijët dhe Familjen (model i miratuar në KD);
- Të kostoje shërbimet e pilotuara për mbështetjen dhe fuqizimin e fëmijës dhe familjes, përfshirë dy komponentët e tjerë, që përmban modeli i SHMFF;
- Të hartojë metodologjinë e trajtimit buxhetor në nivel normativ dhe administrativ të shërbimeve të reja, duke paraqitur një dokumnet që përmban kostot e vlerësuara për ngritjen e Shërbimit të transformuar Komunitar për Fëmijën dhe Familjen, duke kategorizuar kostot bazuar në natyrën e tyre
- Të përgatisë në bashkëpunim me ekspertin ligjor një raport të prezantimit të skemës aktuale të financimit të dy IPSH-ve Vlorë dhe Korçë, si dhe të prezantojë alternativat më eficiente, për mekanizmin e financimit të shërbimeve të reja të transformuara.
- Të prezantojë raportin pranë Komitetit Drejtues të De_i në bashkëpunim me ekspertin ligjor.

Profili i ekspertit ekonomist:

I. Kualifikime

- Diplomë universitare/pas universitare në ekonomi/financë

II. Eksperienca e punës

- Të ketë jo më pak se 10 vite eksperiencë pune në fushën, analizave financiare, kostimit të shërbimeve publike, specifikuat atyre shoqërore, raporteve dhe propozimeve të ndryshimeve të procedurave buxhetor/financiare në përputhje me ndryshimet ligjore (Ligj 121/2016 „Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në RSH“; Ligj 84/2022 „Për Buxhetin viti 2023“ ; VKM 898 date 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës ; Udhëzimi nr 9 date 20.03.2018 etj);
- Të ketë njohuri shumë të mira të ligjit mbi prokurimin publik dhe prokurimin e shërbimeve sociale
- Të jetë njohës shumë i mirë i sistemit të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale
- Të ketë njohuri në fushën e deinstitutionalizimit
- Njohuri shumë të mira në gjuhën angleze në formën e shkruar dhe të folur;
- Mundësi dhe dëshirë për të lëvizur në terren;
- Gadishmëri në përmbushjen e afateve të dakordësuara Aftësi shumë të mira në komunikim, dhe menaxhim të situatave;
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur.

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes të NISMA ARSIS.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 05 dhjetor 2023

Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës dhjetor 2023 – janar 2024

Kjo ekspertizë përfshin 32 ditë pune në ekip (20 ditë për ekspertin ligjor dhe 12 ditë për ekspertin financiar).

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për secilin nga pozicionet e sipër shënuara duhet të dërgojnë me email

- 1- CV-në;
- 2- Letër interesi;
- 3- Letër angazhimi/disponueshmërie;
- 4- Ofertën financiare;
- 5- Taksa e regjistrimit (nëse disponohet).

në adresën e emailit: initiative.arsis@gmail.com deri në datën **03 dhjetor 2023**, mesnatë.

Në vemendjen tuaj që në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: Aplikim grup ekspertësh për zhvillimin e analizës ligjore dhe financiare të procesit të transformimit të Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror 0-5 vjeç

Procedura e Vlerësimit:

Zgjedhja e grupit të ekspertëve do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	30%

Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	20%

Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.